

RAPORT PUNIMESH NR. 7

KONTRATA:

“ADAPTIMI I MASAVE TË INTEGRUARA TË EFIÇENCËS SË ENERGJISË NË SHKOLLËN FILLORE “QAZIM PALI”, BORSH, BASHKIA HIMARË, SHQIPËRI”

Nr.224/87, datë 01.11.2021

MBIKËQYRËS I PUNIMEVE:

Ing. Teuta Thimjo

Liçencë Nr. MK.3543

Tiranë 2022

Përmbajtja

1. Hyrje	3
2. Informacion i përgjithshëm	3
<i>a) Të përgjithshme</i>	<i>3</i>
<i>b) Qëllimi i punimeve</i>	<i>4</i>
<i>c) Mbikëqyrja e punimeve</i>	<i>4</i>
3. Progresi i punimeve (01-31 gusht 2022).....	4
4. Përshkrim i punimeve që janë kryer gjatë periudhës 01-31 gusht 2022	4

1. Hyrje

Shërbimi i supervizionit të punimeve për kontratën “**Adaptimi i Masave të Integruara të Efiçencës së Energjisë në Shkollën Fillore “Qazim Pali”, Borsh, Bashkia Himarë, Shqipëri**”, **Projekti G.A.M.E.S**, po realizohet nga Ing: Teuta Thimjo, me Liçensë Nr. MK.3543, staf i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore.

Ky raport ka si objekt supervizionin e punimeve për objektin Shkolla Fillore “Qazim Pali”, Borsh, punimet e së cilës do të zbatohen gjatë periudhës 01 shkurt 2022 - 30 gusht 2022, nga shoqëria “**BAHAS**” **Sh.p.k.**, me investitor Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore.

Shërbimi i supervizionit bëhet në përputhje me termat e referencës, të hartuara nga klienti.

2. Informacion i përgjithshëm

a) Të përgjithshme

Kontrata:	“Adaptimi i Masave të Integruara të Efiçencës së Energjisë në Shkollën Fillore “Qazim Pali”, Borsh, Bashkia Himarë, Shqipëri”.
Investitor:	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
Kontraktor:	BAHAS Sh.p.k.
Supervizor:	Ing. Teuta Thimjo (Liçenca Nr. MK.354)
Afati i punimeve:	01 shkurt 2022 ÷ 30 gusht 2022
Vlera totale e Kontratës:	76,579,484.0 lekë (pa TVSH) ose 91,895,380.8 lekë (me TVSH)
Vlera e objektit shkolla Qazim Pali:	40,440,124.0 lekë (pa TVSH) ose 48,528,148.8 lekë (me TVSH)

b) Qëllimi i punimeve

Borshi është një fshat bregdetar, në rivierën shqiptare, i cili bën pjesë në bashkinë Himarë. Fshati është shumë i bukur dhe në rritje ekonomike falë turizmit dhe prodhimit të vajit të ullirit. Gjëja që e bën shumë të njohur Borshin është plazhi i tij, i cili është plazhi më i madh në detin Jon (7 km).

Turizmi ka filluar të zhvillohet shumë falë bukurisë së fshatit dhe falë njerëzve miqësorë të tij. Duke vazhduar në këtë mënyrë Borshi do të bëhet shumë shpejt destinacioni më i mirë për turistët në jug të Shqipërisë.

Në Borsh, objekt i kësaj kontrate është dhe rikonstruksioni i Shkollës Fillore “Qazim Pali“. Në të përfshihet rehabilitimi i të gjithë infrastrukturës brenda shkollës me qëllim përmirësimin e shërbimit dhe funksionalitetit.

c) Mbikëqyrja e punimeve

Në kryerjen e punës, mbikëqyrësi duhet të bashkëpunojë në mënyrë të plotë me palët e përfshira në realizimin e kësaj kontrate.

Kohëqëndrimi në objekt

Inxhinieri që është i pranishëm me kohë të plotë në objekt, sipas kontratës i raporton çdo ditë mbikëqyrësit të punimeve të gjitha punimet e kryera në objekt. Mbikëqyrësi informohet një ditë më parë për punimet që do të kryhen, për të cilat ai jep dhe vërejtjet dhe miratimin e tij paraprak. Mbikëqyrësi harton raport për punimet e kryera për situacionet pjesore. Ai i fakton punimet e kryera me inspektim dhe foto të bëra në objekt.

3. Progresi i punimeve (01-31 gusht 2022)

Punimet në këtë objekt po realizohen me ritme normale. Referuar situacionit Nr.7 të punimeve mund të themi se është realizuar rreth 55% e vlerës totale të kontratës dhe 100% e vlerës së objektit Shkolla Fillore “Qazim Pali”.

4. Përshkrim i punimeve që janë kryer gjatë periudhës 01-31 gusht 2022

- *Gjatë këtij muaji kanë përfudnuar të gjitha punimet në shkollën “Qazim Pali”.*
- *F.V. Panel diellor për ngrohjen e ujit;*
- *Matës për Operation & Smart Monitoring;*
- *Kanë përfunduar punimet e riparimit të mureve, tavaneve dhe lysterjeve;*
- *Është bërë pastrimi i kantierit nga kontraktori;*
- *Janë bërë kontrollet dhe testimet përkatëse të të gjitha punimeve dhe paisjeve.*

Fotografi e Shkollës para se te fillonin punimet:



Fotografi të proceseve të punimeve të kryera



Fig. 1, Punime termoizolimi të jashtëm / Punime tarace / Punime dritaresh



Fig. 2: Punime dritaresh / Punime riparimi dhe lyerje



Fig. 3: Punime termoizolimi të jashtëm / Punime tarace / Punime dritarësh



Fig. 4,5: Punime riparimi dhe lysterje / Punime elektrike.



Fig. 6,7: Punime riparimi dhe lyerje / Punime elektrike.



Fig. 8,9: Punime mekanike (tualetet)



Fig. 10,11: Punime termoizolimi të jashtëm / Punime dritësh / Punime tarace / Punime rampe



Fig. 12,13: Punime termoizolim tarace / Punime në çati



Fig. 13: Punime termoizolim të jashtëm / Punime tarace / Punime në çati

MBIKËQYRËS I PUNIMEVE:

Ing. Teuta Thimjo

Liçencë Nr. MK.3543